



Pranuar / Dorezuar Pritje/Prodato Received/Delivery	24.10.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	6421/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.745/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me procesmbajtëse Ardita Perçuku-Shyti në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.745/2022 të datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin e përfaqëson me autorizim Av. nga avokatura

Prishtinë, kundër organit të punësimit/Agjencia e Punësimit në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.745/2022 e datës 30.08.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës , që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt emërimit me numër Nr.272 të datës 18.12.2018, në pozitën “Udhëheqës i Zyrës së Punësimit” në Vushtrri, në kuadër të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, me datën 10.08.2022 ka parashtruar kërkesën me numër Nr.121/2022 tek Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me realizimin e të drejtës për harmonizimin e koeficientit nga 7.5 në 8.

Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, përkundër detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ konform kërkesës së ankuesit, me datë 19.08.2022 në fund të kërkesës së ankuesit vetëm thekson faktin se kërkesa e ankuesit refuzohet sepse nuk ka bazë ligjore.

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datën 30.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5026/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me realizimin e të drejtës nga marrëdhënia e punës, për ngritjen e koeficientit të pagës nga 7.5 në koeficientin 8.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga Agjencia e Punësimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 10.10.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.111/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 5026/2022 të datës 30.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit me numër Nr.121/2022 të datës 10.08.2022 e parashtruar tek APRK-ja; Akt emërimit të ankuesit të datës 18.12.2018; Autorizimi për shërbime ligjore të datës 26.08.2022 nga përfaqësuesi ligjor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.09.2022 nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Konkursin e brendshëm të datës 05.09.2018; Vendimin Nr.362/2018 të datës 27.11.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Vendimin VK.nr.111/2022 të datës 10.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me shtyrjen e afatit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht udhëheqësin më të lartë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën e datës 10.08.2022 të parashtruar nga ankuesi

SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Njësia për Burime Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës nuk e ka adresuar dhe rrjedhimisht shqyrtuar kërkesën me numër protokollit Nr.121/22 datës 10.08.2022 të parashtruar nga ankuesi, respektivisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8), andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me kërkesën-ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e



nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shitesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*". Pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar përgjigjen e organit të punësimit dhënë për Këshillin në të cilën është deklaruar se, varësisht se udhëheqësit e këtyre zyrave a i përkasin komunave të mëdha apo të vogla e realizojnë edhe koeficientin e tyre, e që sipas kësaj shkrese del se udhëheqësit e zyrave të punësimit të cilët punojnë tek komunat të cilat konsiderohen si të mëdha mbajnë koeficientin tetë (8) ndërsa tek komunat të cilat konsiderohen si të vogla mbajnë koeficientin shtatë pikë pesë (7.5), mirëpo që përshkrimin e detyrave të punës e kanë të njëjtë. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndërlidhur me përgjigjen e organit të punësimit ka konstatuar se, institucioni i punësimit nuk ka arritur të vërtetoj faktin se mbi cilën bazë ligjore është mbështetur, kur ka deklaruar se mos harmonizimi i koeficientëve dhe pa barazia ndërmjet Udhëheqësve të zyrave rajonale të punësimit mbështetet tek pretendimi sa i përket ndarjes së komunave si "e madhe- e vogël".

Andaj, duke marrë parasysh rrethanat si më lartë, Kolegji konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, është i obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e kërkesës së datës 10.08.2022, e parashtruar nga ankuesi në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike lidhur me atë se nëpunësit e këtij institucioni respektivisht Udhëheqësit e zyrave rajonale të punësimit në komuna të ndryshme çfarë koeficienti realizojnë dhe a e realizojnë koeficientin e njëjtë për punën e njëjtë që kryejnë, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me këtë çështje në pajtim me dispozitat e nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.745/2022, datë 24.10.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në MFPT;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në MFPT dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.